



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS  
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS  
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

**Numri i lëndës:** KSC-BC-2020-07  
**Prokurori kundër Hysni Gucatit dhe Nasim Haradinajt**

**Vendosi:** **Trupi Gjykses II**  
Gjykatës Çarls L. Smith, III, Kryegjykatës  
Gjykatës Kristof Barte  
Gjykatës Ginel Metro  
Gjykatës Fergal Gejnor, gjykatës rezervë

**Administratore:** Fidelma Donlon

**Data:** 10 shkurt 2022

**Gjuha:** Anglishte

**Klasifikimi:** Publik

---

**Vendim mbi Redaktimet e Propozuara në P00104**

---

**Prokurorit të Specializuar**

Xhek Smith  
Valeria Boliçi  
Mathju Halling  
Xhejms Paç

**Mbrojtjes së Hysni Gucatit**

Xhonatan Elistan Ris  
Hju Bauden  
Elinor Stivenson

**Mbrojtjes së Nasim Haradinajt**

Tobi Kadman  
Karl Bakli  
Xhonathan Piter Uorbois

**TRUPI GJYKUES II** (“Trupi Gjykues”), në bazë të neneve 21 dhe 40(6)(d) dhe (f) të Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji”) dhe rregullës 84(1) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës (“Rregullorja”), merr këtë vendim.

## I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 23 nëntor 2021, në vijim të urdhrorit të Trupit Gjykues,<sup>1</sup> Zyra e Prokurorit të Specializuar (“ZPS”) dorëzoi një version të redaktuar publik të propozuar të P00104.<sup>2</sup>
2. Më 13 dhjetor 2021, ZPS-ja dorëzoi një version të redaktuar publik të ndryshimeve të propozuara në P00104 (“Redaktimet e Propozuara në P00104”).<sup>3</sup>
3. Më 15 dhjetor 2021, Mbrojtja e Hysni Gucatit (“Mbrojtja e Gucatit”) i kundërshtoi Redaktimet e Propozuara në lidhje me P00104 mbi bazën se dokumentet e përfshira në provën materiale ishin publike.<sup>4</sup>
4. Më 17 dhjetor 2021, Trupi Gjykues urdhëroi ZPS-në që, ndër të tjera, të dorëzonte parashtrime të mëtejshme në lidhje me Redaktimet e Propozuara në P00104.<sup>5</sup> Në veçanti, Trupi Gjykues urdhëroi ZPS-në të dorëzonte parashtrime të mëtejshme për sa vijon: (i) cilat nga dokumentet e përfshira në P00104 ishin të disponueshme publikisht nga burime zyrtare në Kosovë, dhe nëse ato ishin të disponueshme publikisht nga ato burime në formë të redaktuar ose të paredaktuar; (ii) detaje të mëtejshme në lidhje me praktikën e gjykatave të Kosovës dhe Prokurorisë Speciale të

---

<sup>1</sup> F00427, Trupi Gjykues, *Vendim mbi Pranueshmërinë e Provave Materiale të Shtyra dhe Klasifikimin e Disa Provave të Pranuara*, 9 nëntor 2021, para. 68(j).

<sup>2</sup> F00445, Prokurori i Specializuar, *Parashtrime në Përputhje me Vendimin e Trupit Gjykues F00427*, 23 nëntor 2021, me Shtojcën 1, konfidenciale.

<sup>3</sup> F00492, Prokurori i Specializuar, *Parashtrim i Versionit të Redaktuar Publik të Ndryshime të Propozuara në P00104*, 13 dhjetor 2021, me Shtojcën 1, konfidenciale (“Redaktimet e Propozuara P00104”, “F00492/A01”).

<sup>4</sup> F00498, Mbrojtja e Gucatit, *Përgjigje ndaj Parashtrimit prej ZPS-së të Versionit të Redaktuar Publik të Ndryshimeve të Propozuara në P00104*, 15 dhjetor 2021.

<sup>5</sup> F00503, Trupi Gjykues, *Vendim mbi Redaktimet e Propozuara të Disa Provave Materiale të Pranuara* (“Vendimi mbi Redaktimet e Propozuara”), 17 dhjetor 2021, para. 18, 22 (c).

Republikës së Kosovës për redaktime në dokumente publike, dhe bazën ligjore për zbatimin e këtyre redaktimeve; (iii) për secilin dokument të përfshirë në P00104, arsye specifike për të justifikuar kërkesën e ZPS-së për redaktime, veçanërisht kur redaktime të tilla janë më të gjera se ato të zbatuara nga gjykatat e Kosovës dhe Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës; dhe (iv) aty ku ZPS-ja ka shënuar për redaktim pjesë specifike të një faqeje dhe të gjithë faqen, qartësim nga ZPS-ja se çfarë kërkon të redaktojë.<sup>6</sup>

5. Më 24 janar 2022, ZPS-ja dorëzoi parashtrime të mëtejshme për redaktimet e propozuara ("Parashtrimet e Mëtejshme").<sup>7</sup>

6. Mbrojtja nuk dorëzoi asnjë përgjigje ndaj Parashtrimeve të Mëtejshme brenda afatit të urdhëruar nga Trupi Gjykses.

## II. PARASHTRIMET

7. ZPS-ja parashtron se të gjitha redaktimet e propozuara në lidhje me P00104 pasqyrojnë redaktimet e zbatuara nga gjykatat e Kosovës në versionet në internet të aktgjyqimeve dhe materialeve të tjera të përfshira në P00104. ZPS-ja bën të ditur se Shtojca 1 e Parashtrimeve të Mëtejshme rendit versionet e disponueshme në internet të secilit prej dokumenteve të përfshira në P00104. Redaktimet në ato versione janë pasqyruar në redaktimet që ka propozuar ZPS-ja për provën materiale P00104. ZPS-ja parashtron se asnjë nga redaktimet e propozuara nuk është më i gjerë se redaktimet e zbatuara nga gjykatat e Kosovës në materialet e disponueshme në internet.<sup>8</sup>

8. ZPS-ja parashtron gjithashtu një version të rishikuar të redaktimeve të propozuara në lidhje me fragmentet e përfshira në faqet 628-636 të P00104,<sup>9</sup> për të pasqyruar në

---

<sup>6</sup> Vendimi mbi Redaktimet e Propozuara, para. 18.

<sup>7</sup> F00531, Prokurori i Specializuar, *Parashtrime të Mëtejshme mbi Versionin e Redaktuar Publik të P00104* ("Parashtrimet e Mëtejshme"), 24 janar 2022, me Shtojcat 1, 2 dhe 3 ("F00531/A01") publike dhe Shtojcën 4 ("F00531/A04"), konfidenciale.

<sup>8</sup> Parashtrimet e Mëtejshme, para. 2.

<sup>9</sup> Redaktimet e Propozuara në P00104, f. 629-637.

mënyrë më të qartë dhe më të saktë redaktimet e zbatuara në versionin e gjykimit përkatës që gjendet në internet (“Redaktimet e Rishikuara”).<sup>10</sup> ZPS-ja parashtron më tej se aty ku ka vendosur shënime për redaktim (a) në pjesë specifike të një faqeje dhe (b) në të gjithë faqen, ZPS-ja kërkon një urdhër për të redaktuar të gjithë faqen në fjalë, “pasi nuk u identifikua asnjë version publik ose nga burim i hapur i dokumentit” (“Redaktimet e Plota”).<sup>11</sup>

### III. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

9. Në pajtim me nenin 40(6)(d) dhe (f) të Ligjit, Trupi Gjykses mund të ofrojë mbrojtjen e informacioneve konfidenciale si dhe mbrojtjen e të akuzuarve, dëshmitarëve dhe viktimave.

10. Sipas rregullës 84(1) të Rregullores, Trupi Gjykses rishikon vazhdimisht klasifikimin e provave dhe, kur është e zbatueshme, urdhëron riklasifikimin e tyre.

### IV. DISKUTIM

11. Trupi Gjykses ka shqyrtuar versionet në internet të disponueshme publikisht të dokumenteve të përfshira në P00104 (*d.m.th.* Shtojca 1 e Parashtrimeve të Mëtejshme) dhe i ka krahasuar ato me Redaktimet e Propozuara në P00104 dhe Redaktimet e Rishikuara. Trupi Gjykses gjithashtu ka shqyrtuar Redaktimet e Plota, shumica e të cilave kanë të bëjnë me dokumente të cilat nuk janë të disponueshme në internet nga burime zyrtare. Trupi Gjykses vëren gjithashtu se, ndërsa Mbrojtja e Gucatit kundërshtoi Redaktimet e Propozuara në P00104 në bazë të faktit se dokumentet e përfshira në provën materiale ishin publike,<sup>12</sup> asnjë prej ekipeve të Mbrojtjes nuk i ka kundërshtuar Redaktimet e Rishikuara ose Redaktimet e Plota.

---

<sup>10</sup> Parashtrimet e Mëtejshme, para. 5 që i referohet F00531/A04.

<sup>11</sup> Parashtrimet e Mëtejshme, para. 6.

<sup>12</sup> *Shih* më sipër para.

12. Në lidhje me Redaktimet e Propozuara në P00104, Trupi Gjykses vëren se, përveç përjashtimeve të kufizuara, ato pasqyrojnë çka është zbatuar nga gjykatat e Kosovës në versionet e dokumenteve të disponueshme publikisht. Në lidhje me redaktimet e kufizuara shtesë të zbatuara nga ZPS-ja, Trupi Gjykses vëren se nëpërmjet disa prej tyre duket se synohet të sigurohet redaktim përputhës i informacionit të ngjashëm brenda një dokumenti.<sup>13</sup> Redaktime të tjera shtesë duket se synojnë të sigurojnë heqjen në mënyrë përputhëse të informacionit të ngjashëm nëpër dokumente të ndryshme.<sup>14</sup> Të gjitha këto redaktime shtesë të propozuara gjithsesi mbulojnë informacion që identifikon persona të akuzuar, dëshmitarë ose individë të tjerë të lidhur me procedurat gjyqësore përkatëse. Megjithatë, një numër i vogël i redaktimeve të mëtejshme të propozuara që i referohen jurisprudencës së Kosovës ose asaj ndërkombëtare duket se janë të tepruara.<sup>15</sup> Në veçanti këto kanë të bëjnë me redaktimet e referencave ndaj aktgjykimeve dhe vendimeve të TPNJ-së, TPNR-së, GJEDNJ-së dhe të Kosovës që kanë të bëjnë me standardet ligjore dhe nuk janë redaktuar në versionet e tyre në internet. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses konstaton se Redaktimet e Propozuara në P00104, përveç atyre që redaktojnë referencat lidhur me jurisprudencën e Kosovës ose atë ndërkombëtare,<sup>16</sup> janë në përputhje me të drejtat themelore të të akuzuarve dhe parimin e gjykimit publik, duke qenë se kanë qëllimin legjitim të mbrojtjes së dëshmitarëve dhe privatësisë së personave të akuzuar si dhe individëve të tjerë, dhe janë proporcionale e të domosdoshme për këtë qëllim.

---

<sup>13</sup> Redaktimet e Propozuara në P00104 , f. 21, 81, 308, 309, 538, 538 Numrat e faqeve i referohen F00492/A01 dhe janë një shifër më lart nga numrat e përmendur në F00531/A01. Kjo vlen për të gjitha poshtëshënimet pasuese në këtë parashtrim që u referohen Redaktimeve të Propozuara në P00104.

<sup>14</sup> Redaktimet e Propozuara në P00104 f. 8-9, 16-17, 21, 26, 129-163, 166, 170, 200 (para. 69), 252, 412, 414, 529-530, 535, 541-544, 560, 567, 597, 639, 762-763, 811, 814-815, 817-818, 821, 835 ku informacione të ngjashme, duke përfshirë emrat e avokatëve të Mbrojtjes, propozohen të redaktohen në disa dokumente, në versionet në internet së të cilave jo domosdoshmërisht ka përputhje në fshirjen e të njëjtit informacion.

<sup>15</sup> Redaktimet e Propozuara në P00104 f. 277, 279, 551-553, 776 (poshtëshënimi 2).

<sup>16</sup> Redaktimet e Propozuara në P00104 f. 277, 279, 551-553, 776 (poshtëshënimi 2).

13. Në lidhje me Redaktimet e Rishikuara, Trupi Gjykses vëren se ato pasqyrojnë çka është zbatuar në versionin publik të të njëjtit dokument.<sup>17</sup> Trupi Gjykses vëren më tej se Redaktimet e Rishikuara mbulojnë emrat dhe mbiemrat e individëve të lidhur me procese të tjera gjyqësore si dhe detajet personale të individëve të tillë. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses konstaton se Redaktimet e Rishikuara janë në përputhje me të drejtat themelore së të akuzuarve dhe parimin e gjykimit publik, duke qenë se kanë qëllimin legjitim të mbrojtjes së privatësisë së individëve, dhe janë proporcionale e të domosdoshme për këtë qëllim.

14. Në lidhje me Redaktimet e Plota, Trupi Gjykses vëren se këto janë zbatuar në dy raste: (i) kur nuk mund të identifikohet asnjë version publik ose me burim të hapur i dokumentit;<sup>18</sup> dhe (ii) kur teksti i propozuar është i disponueshëm publikisht nga një burim zyrtar me redaktime më të kufizuara.<sup>19</sup> Në lidhje me rastin e parë, Trupi Gjykses vëren se dokumentet në fjalë përmbajnë një aktakuzë dhe procesverbale lidhur me hetimin. Në përputhje me këtë, në mungesë të një versioni publik të këtyre dokumenteve, Trupi Gjykses e gjykon të kujdesshme të autorizojë Redaktimet e Plota të propozuara nga ZPS-ja. Në lidhje me rastin e dytë, Trupi Gjykses vëren se as redaktimet e plota dhe as ato specifike të propozuara nga ZPS-ja nuk reflektojnë modifikimet e bëra në versionet e disponueshme publike të dokumenteve nga burime zyrtare. Këto përmbajnë redaktime të emrave dhe informacione të tjera identifikuese, por lënë të pafshirë përmbajtjen e përgjithshme të tekstit. Për këtë arsye, Trupi Gjykses vlerëson se redaktimet e zbatuara në versionet e disponueshme publikisht nga burimet zyrtare janë më të përshtatshme. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses konstaton se Redaktimet e Propozuara, përveç atyre që nuk pasqyrojnë versionet zyrtare të redaktuara, të disponueshme publikisht,<sup>20</sup> janë në përputhje me të drejtat themelore

---

<sup>17</sup> Parashtrimet e Mëtejshme, F00531/A01, f. 2 dhe F00531/A04. *Shih gjithashtu* [https://www.eulex-kosovo.eu/eul/repository/docs/126431-PML.KZZ\\_no.322-2016.pdf](https://www.eulex-kosovo.eu/eul/repository/docs/126431-PML.KZZ_no.322-2016.pdf).

<sup>18</sup> Redaktimet e Propozuara në P00104 f. 417, 496, 616- 776

<sup>19</sup> Redaktimet e Propozuara në P00104 f. 38-39, 525-526, 761-762, 809, 834.

<sup>20</sup> Redaktimet e Propozuara në P00104 f. 38-39, 525-526, 761-762, 809, 834.

të të akuzuarve dhe parimin e gjykimit publik, duke qenë se ato kanë qëllimin legjitim të mbrojtjes së dëshmitarëve dhe privatësisë së personave të akuzuar si dhe individëve të tjerë, dhe janë proporcionale e të domosdoshme për këtë qëllim.

15. Për arsyet e lartpërmendura, Trupi Gjykses autorizon: (i) Redaktimet e Propozuara në P00104 me përjashtim të atyre të përmendura në paragrafin 12 që kanë të bëjnë me jurisprudencën e Kosovës ose atë ndërkombëtare;<sup>21</sup> (ii) Redaktimet e Rishikuara në tërësi; dhe (iii) Redaktimet e Plota me përjashtim të atyre të përmendura në paragrafin 14 pasi nuk pasqyrojnë versionet e redaktuara që janë të disponueshme publikisht nga burimet zyrtare. Në lidhje me këtë të fundit, Trupi Gjykses urdhëron ZPS-në të zbatojë redaktimet në përputhje me ato të bëra në versionet e disponueshme publike të dokumenteve përkatëse. Ky vendim nuk cenon vendimet e ardhshme të Trupit Gjykses mbi natyrën publike ose konfidenciale të dokumenteve të përfshira në P00104.

## V. VENDIM

16. Për këto arsye, Trupi Gjykses:

- a. **URDHËRON** ZPS-në të zbatojë:
  - i. Redaktimet e Propozuara në P00104, brenda kufijve të përcaktuar në paragrafët 12 dhe 15;
  - ii. Redaktimet e Rishikuara;
  - iii. Redaktimet e Plota, brenda kufijve dhe me rendin shtesë të përcaktuar në paragrafët 14 dhe 15;
- b. **URDHËRON** ZPS-në të paraqesë një version publik të redaktuar të provës materiale P00104 në përputhje me urdhrat e mësipërm deri më **18 shkurt 2022**; dhe

---

<sup>21</sup> Redaktimet e Propozuara në P00104 f. 277, 279, 551-553, 776 (poshtëshënimi 2).

c. **UDHËZON** Administratoren ta shënojë versionin e redaktuar publik si  
P00104\_RED.

/nënshkrim/  
**Gjykatës Çarls L. Smith, III**  
**Kryegjykatës**

E enjte, 10 shkurt 2022

Hagë, Holandë